




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSOR PRIVAT  
SHOQËRIA PËRMBARIMORE "AA BAILIFF" SH.P.K.

Nr.2648.Prot.  
Dosje Nr. 1673

Tiranë, më 09/06/2021

**URDHËR**

**"Për vendosjen e sekuestros mbi kuotat e debitorit"**



Drejtuar: **QENDRËS KOMBËTARE TË REGJISTRIMIT**

Unë **Oltion Naumi** përmbarues gjyqësor privat pranë Shoqërisë "AA Bailiff" sh.p.k., pasi studiova materialet e dosjes përmbarimore Nr. 1673, bazuar në Urdhrine e ekzekutimit – Vendim Nr. 4248 Vendimi, datë 13/10/2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë,

**KONSTATOVA:**

Se më datë 04/05/2021 është lidhur kontrata e shërbimit midis shoqërisë përmbarimore "AA Bailiff" sh.p.k dhe kreditorit Tranzit Shpk, me objekt ekzekutimin e Titullit Ekzekutiv – Vendim Nr. 4248 Vendimi, datë 13/10/2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me palë dhe objekt:

- **Kreditor:** Tranzit shpk (Kontrate datë 21/10/2016)
- **Debitorë:** Shoqëria NITO me Nipt K81721025Q
- **Objekti:** Pagesë detyrimi

Për ekzekutimin e Urdhërit të Ekzekutimit, duhet të kryhet vënia e sekuestros mbi çdo pasuri të debitorit me qëllim shlyerjen e detyrimit ndaj kreditorit Tranzit sh.p.k.

Për sa më sipër, si dhe në zbatim të neneve 519, 527, 560, 563 e në vijim të K.Pr.Civile si dhe të Ligjit Nr. 10031 datë 11.02.2008 "Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat"

**URDHËROJ:**

Vendosjen e sekuestros mbi subjektin:

- **Shoqëria NITO me Nipt K81721025Q, Dyqani nr 2 në kuatën -3.15 në sheshin Karl Topia Tiranë;**

duke ndaluar disponimin ose tjetërsimin e tyre, si dhe ushtrimin e të drejtave që rrjedhin nga këto kuota.

1. Për veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.
2. Për personat që bëhen pengesë, do të aplikohet sanksioni i gjobës në zbatim të nenit 606 te K.Pr.Civile si dhe kallëzimi për ndjekje penale në zbatim të nenit 320 të K.Penal.
3. Ky urdhër u njoftohet palëve të interesuara, të cilat kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve.

**SHOQËRIA "AA BAILIFF" SHPK  
PËRMBARUESI GJYQËSOR  
OLTION NAUMI**

